

## Rrjeti për Ruajtjen e Cetaceve dhe Breshkave Detare në Adriatik

Projekti NETCET financohet nga Programi IPA Adriatik CBC dhe përfshihet në Prioritetin 2 “Burimet Natyrore dhe Kulturore dhe Parandalimi i Rreziqeve”.

Qëllimi kryesor i këtij programi bashkëpunimi ndërkuftar është forcimi i kapaciteteve për një zhvillim të qëndrueshëm të rajonit të Adriatikut, nëpërmjet një strategjie të përbashkët aktivitetesh midis vendeve partnere të këtij rajoni.

Faqja ëeb e projektit: [www.adriaticpacbc.org](http://www.adriaticpacbc.org)

### PËRMBLEDHJE

1. Zhvillimet mbi krijimin e Taskforcës për Emergjencën në Adriatik: rezultate nga takimi i Kioxhas.
2. Qendra të reja të emergjencës dhe reabilitimit të breshkave detare në Kroaci.
3. Qendra e rinovuar e shpëtimit të breshkave detare në Pula, Kroaci.
4. Ndërgjegjësimi i komunitetit të peshkatarëve në Shqipëri.
5. Fillimi i aktiviteteve edukative të NETCET me nxënësit e shkollave.
6. Bashkia e Venecias promovon një praktikë të mirë për projektin NETCET.

## 1. Zhvillimet mbi krijimin e Taskforcës për Emergjencën në Adriatik: rezultate nga takimi i Kioxhas



Adriatiku është një det gjysëm i mbyllur, i karakterizuar nga tipare të veçanta morfologjike dhe gjeografike. Këto tipare, si dhe aktivitetet njerëzore si transporti, nxjerrja e naftës dhe prania e njeriut përgjatë të gjithë vijës bregdetare rrisin mundësinë e katastrofave detare në këtë zonë. Për këtë arsye Projekti NETCET ka planifikuar një aktivitet të posaçëm për krijimin e një Taskforce për Emergjencën në Adriatik, me qëllim për të përballuar situatë të tilla si ngordhjet masive të kafshëve, katastrofat mjedisore dhe situata të tjera të rrezikshme për cetacetë dhe breshkat detare. Ky aktivitet është në përputhje edhe me detyrimet institucionale në kuadër të Rekomandimit 4.16 të ACCOBAMS.

Takimi i parë u zhvillua në Kioxha, Itali, në Mars 2014, me pjesëmarrjen e partnerëve të NETCET të përfshirë në këtë

aktivitet, me qëllim për të ndarë përvojat, njohuritë, protokollet, kuadrin ligjor dhe pajisjet që duhet të përdoren në rastet e emergjencave të sipërpërmendura. Raste të tilla të raportuara kanë qenë të rralla vitet e fundit, shumica e të cilave të lidhura me shkaqe natyrore (p.sh. ngordhje masive të pazakonshme), por një shqetësim i madh lidhet me rritjen e numrit të lejeve për aktivitete sizmike në të dy brigjet e Adriatikut. Pothuajse të gjithë vendet e Adriatikut rrezikojnë të përballen me katastrofa mjedisore, si p.sh. ndotjet nga karburantet, ndërkohë që ka protokolle të posaçme për bashkëpunimin mes vendeve të Adriatikut, si Plani Rajonal për parandalimin dhe reagimin ndaj incidenteve të ndotjeve të rënda në Detin Adriatik. Në bazë të konventave ekzistuese, të tre vendet e Adriatikut Verior, Italia, Sllovenia dhe Kroacia kanë nënshkruar një marrëveshje tre-palëshe për bashkëpunim me ekspertizë, pajisje dhe masa të përbashkëta kundër incidenteve të ndodhura dhe incidenteve të mundëshme të ndotjeve të Detit Adriatik në vendet përkatëse.

Duke filluar nga takimi i Kioxhas, krijimi i Taskforcës për Emergjencën në Adriatik do të marrë patjetër në konsideratë këto marrëveshje me qëllim për të propozuar përfshirjen edhe të vendeve të tjera, krahas Italisë, Sllovenisë dhe Kroacisë, gjithashtu duke përfshirë edhe protokolle, njësi koordinuese, si dhe një listë ekspertësh të biologjisë detare, veçanërisht për breshkat detare dhe cetacetë, siç është parashikuar në rekomandimet e ACCOBAMS.

Për më tepër, të gjithë partnerët e NETCET do të ftohen për të marrë pjesë në një workshop të posaçëm mbi koordinimin dhe menaxhimin e ngordhjeve masive të pazakonshme të cetaceve, i cili do të zhvillohet në Padova, në Dhjetor 2014. Në fillim të vitit 2015, në kuadër të Projektit NETCET, është planifikuar një takim në Pula (Kroaci), ku do të paraqitet propozimi mbi Taskforcën për Emergjencën në Adriatik.

Ndërkohë, të gjithë ekspertët e përfshirë në projekt janë duke bashkëpunuar për përbalimin e situatave të daljes së cetaceve në plazhe, si dhe në forcimin e rrjetit shkencor dhe teknik në Adriatik, të krijuar nga Projekti NETCET.

*Sandro Mazzariol – Universiteti i Padovës*

## 2. Qendra të reja të emergjencës dhe rehabilitimit të breshkave detare në Kroaci



Një nga qëllimet e Projektit NETCET është që të forcojë kapacitetet teknike për shërimin dhe trajtimin e breshkave detare. Në Kroaci, Instituti Shtetëror për Mbrojtjen e Natyrës ka organizuar dhe drejton Sistemin Kombëtar të Sinjalizimit dhe Monitorimit të llojeve të mbrojtura strikte të kafshëve të kapura, të vrara, të plagosura ose të sëmura. Në kuadër të këtij sistemi, gjatë vitit 2010 u përgatit protokoli për kafshët detare të mbrojtura strikte (gjitarët, breshkat dhe peshqit kartilagjinorë) dhe u ngritën 11 klinika dhe ambulanca veterinare të ndihmës së shpejtë në brigjet dhe ishujt e Adriatikut.

Klinikat dhe ambulancat veterinare, të cilat veprojnë si qendra emergjence, ose si qendra ndihmëse për breshkat detare variojnë sipas vendeve dhe kapaciteteve. Instituti Veterinar i Kroacisë dhe Fakulteti i Mjeksisë Veterinare janë gjithashtu të përfshirë në rrjet. Në sajë të Projektit NETCET qendrat veterinare të emergjencës janë pajisur në Pula, Rijeka, Senj, Pag, Zadar, Šibenik, Split, Korčula dhe Dubrovnik, ndërsa qendrat ndihmëse në Krk, Mali Lošinj dhe Brač. Stafit i veterinerëve është trajnuar nga ekspertë përkatës të Universitetit të Padovës gjatë një kursi trajnimi që synonte përmirësimin dhe standartizimin e kujdesit veterinar, kirurgjisë, nekropsisë dhe menaxhimin e daljeve në plazhe të cetaceve dhe breshkave detare.

Krahas programit edukativ, çdo qendër emergjence dhe qendër ndihmëse është pajisur sipas nevojave me mjete të thjeshta veterinare, pajisje të vogla laboratorike, materiale konsumi, GPS dore, aparate fotografike, frigoriferë

terreni, enë plastike, ngrohës akuariumi, peshqirë etj., në mënyrë që të forcohen kapacitetet e tyre teknike për ndërhyrjet e nevojshme.

Në sajë të këtij rrjeti të qendrave të emergjencës, nga Janari 2013 deri në Qershor 2014, janë strehuar 10 breshka detare, ndërkohë që janë grumbulluar 74 individë të ngordhur. Kur zhgualli i breshkave ka qenë në kushte të mira, është bërë nekropsia në një nga qendrat e emergjencës ose në Institutin Veterinar të Kroacisë. Në qendrat e emergjencës u shëruan me sukses 7 breshka, të cilat edhe u rikthyen në det, ndërsa 3 individë të tjerë u dërguan në qendrën e reabilitimit në Pula për një periudhë më të gjatë shërimi (shih artikullin e mëposhtëm).

Pas trajnimit dhe përmirësimit të kapaciteteve teknike të rrjetit të qendrave të emergjencës, si dhe me realizimin e aktiviteteve ndërgjegjësuere me grupe të ndryshme të interesit në kuadër të Projektit NETCET, është konstatuar një rritje e dukshme e efikasitetit të qendrave të emergjencës dhe sistemit të sinjalizimit. Një shembull shumë i mirë është ai i një breshke deti të shëruar në qendrën e emergjencës në Split. Gjymtyra e perparme e breshkës qëndronte e palosur nga ngecja e një rrjete peshkimi, duke shkaktuar procese nekrotike. Ky problem u eliminua në qendrën e emergjencës në Split dhe breshka është duke qendruar për shërim në Qendrën e Edukimit Detar në Pula (partner i NETCET), në Parkun Kombëtar të Briunit, e pajisur me kontenerë të përshtatshëm për reabilitim. Breshka është aktualisht në gjendje shumë të mirë dhe nëse gjendja vazhdon të jetë e tillë, atëherë lëshimi i saj në det do të bëhet në vjeshtë të këtij viti.

*Jasna Jeremic – State Institute for Nature Protection, Kroaci*

### 3. Qendra e rinovuar e shpëtimit të breshkave detare në Pula, Kroaci

Qendra Edukative Detare e Pulas (MEC Pula) është një organizatë jo qeveritare, e cila vepron edhe si qendër e shpëtimit të breshkave detare që prej vitit 2006. Si një partnere e Projektit NETCET, një nga aktivitetet e saj ishte rinovimi i qendrës, gjë që u paraqit në publik me 24 Prill 2014.

Aktiviteti filloi me një përshëndetje nga presidentja e MEC Pula, Dr. Milena Mičić, e cila foli edhe mbi historinë e kësaj qendre. Pas një njohjeje me projektin, qëllimet dhe aktivitetet e tij, u bë një vizitë në qendrën e rinovuar. Nga të ftuarit në këtë aktivitet vlen të përmenden Dr. Matija Franković, drejtor i Institutit Shtetëror për Mbrojtjen e Natyrës në Koraci, partner i projektit, si dhe Kristina Fedel Timovski, përgjegjëse e Departamentit të Mardhënieve Ndërkombëtare dhe Politikave Evropiane në Bashkinë e Pulas.



Qendra e Shpëtimit të Breshkave Detare ndodhet në katin e dytë të Fort Verudela, një fortesë Austro-Hungareze e vitit 1886. Përpara rinovimit kjo qendër kishte vetëm një dhomë me infrastrukturë për shërimin e njëkohshëm të maksimumi 6 breshkave, por pa sistem të përshtatshëm filtrimi dhe

vetëm me ngrohës të zhytur në ujë për periudhën e dimrit.

Aktualisht, Qendra e Shpëtimit të Breshkave Detare ka 3 dhoma (e reabilitimit, e laboratorit dhe ndihmës së shpejtë, si dhe dhoma e aktiviteteve edukative), me sistem të pavarur filtrimi dhe ngrohjeje për vaskat e breshkave. Kapaciteti është rritur në 9 vaska, si dhe është përmirësuar diagnostifikimi dhe reabilitimi i breshkave, në sajë të pajisjes me instrumente të reja për analizat e gjakut.

Të gjitha pajisjet ndihmëse dhe tavolinat e ekzaminimit janë rinovuar. Një dhomë e re me sipërfaqe 40 m<sup>2</sup> është hapur me qëllim shfaqjen e posterave mbi biologjinë e breshkave, një ekrani edukativ, si dhe këndit të fëmijëve. Aktualisht qendra ka 2 breshka, “Sara” me plagë në aparatit tretës dhe “Severina” e konfiskuar në

Vranjic, Split, nga Ministria e Mbrojtjes së Natyrës. Me 20 Qershor 2014 nga kjo qendër u lëshuan 4 breshka gjatë ceremonisë vjetore të lëshimit të breshkave, organizuar nga MEC.

Krahas rinovimit, aktivitetet e MEC Pula gjatë 3 viteve të zbatimit të projektit janë edhe ndërgjegjësimi i përdoruesve të varkave dhe anijeve, duke prodhuar dhe shpërndarë postera në portet kroate, duke organizuar aktivitete për lëshimin e breshkave në det dhe duke dhënë informacione mbi breshkat gjatë vizitave në këtë qendër.

*Karin Gobić, Akuariumi i Pulas dhe Marine Educational Centre Pula*

## 4. Ndërgjegjësimi i komunitetit të peshkatarëve në Shqipëri

Shqipëria ka një vijë bregdetare me gjatësi 427 km, ku komunitetet më të mëdhenj të peshkatarëve gjenden në katër portet kryesore: Shëngjin, Durrës, Vlorë dhe Sarandë. Gjithashtu, ka edhe grupe të tjerë më të vegjël peshkatarësh në zona të tjera. Në kuadër të Projektit NETCET grupi i punës i Shoqatës së Herpetofaunës së Shqipërisë ka bërë takime me peshkatarët e porteve të Adriatikut, si dhe me 2 grupe të vegjël peshkatarësh në Patok dhe Rodon.



Takimet kanë filluar në vjeshtën e vitit 2013 dhe vazhdojnë aktualisht, ku deri tani përfaqësuesit e HAS kanë takuar rreth 100 peshkatarë. Së pari, në këto takime janë paraqitur objektivat e Projektit NETCET, si dhe kontributi i HAS, si një nga partnerët e projektit. Ekspertët e HAS kanë shpjeguar edhe detaje nga biologjia dhe ekologjia e breshkave detare, me qëllim që komuniteti i peshkatarëve të kuptojë sa më mirë rëndësinë e këtyre kafshëve dhe rolin e tyre në ekosistemin detar. Gjithashtu, është shpjeguar edhe ndikimi i njeriut në mjedis dhe aktivitetet negative që çojnë rë rrezikun e zhdukjes së disa llojeve detare. Peshkatarëve u është dhënë edhe një informacion i përmblodhur mbi humbjet e biodiversitetit si rezultat i praktikave të gabuara të shfrytëzimit të burimeve natyrore.

Pjesa e dytë e këtyre takimeve fokusohet në demonstrime se si peshkatarët mund të trajtojnë breshkat detare të dëmtuara që mund t'i gjejnë duke plluskuar në ujë, ose të ngecur në rrjetat e peshkimit. Ilustrohen aspekte të trajtimit dhe lëshimit të breshkave në det, mënyra e duhur e transportit të tyre nga deti dhe drejt detit, si dhe aspekte të tjera të lidhura me shëndetin e tyre.

Ekspertët shpjegojnë rëndësinë e pjesmarrjes së komunitetit të peshkatarëve në politikat e ruajtjes së këtyre kafshëve, të cilat janë vlerësuar nga IUCN si lloje të kërcënuara në shkallë globale. Ekspertët synojnë që peshkatarët të kuptojnë se përpjekjet më të mira për ruajtjen e breshkave detare nuk vijnë nga qeveria dhe as nga studiuesit, por nga vetë peshkatarët, të cilët janë në kontakt të përditshëm me këto kafshë detare.

Gjatë këtyre takimeve janë shpërndarë produkte si bluza, fletëpalosje dhe çanta me informacione ndërgjegjësuere të prodhuara nga WWF Itali dhe Bashkia e Venecias, të përkthyer në shqip nga HAS. Postera me titullin “Si i shpëtojnë peshkatarët breshkat detare”, të përgatitur nga WWF Itali, janë ngjitur tek anijet e peshkimit, tek zonat publike të porteve, si dhe në lokalet (bar, restorant) që përdoren nga peshkatarët. Në këto vende janë publikuar udhëzimet mbi trajtimin e kafshëve të plagosura, si dhe informacione të tjera mbi breshkat detare dhe cetacetë. Këto informacione do të ndihmojnë peshkatarët në përpjekjet e tyre për të ndihmuar breshkat në nevojë.

Takimet do të vazhdojnë me grupe të tjerë të vegjël peshkatarësh përgjatë bregdetit shqiptar dhe HAS ka planifikuar organizimin e një serie të dytë takimesh me grupet e peshkatarëve të porteve të cilët kanë qenë takuar më parë, me qëllim për të kuptuar se sa të efektshëm kanë qenë takimet e para.

*Vilma Piroli, Herpetofauna Albanian Society*

## 5. Fillimi i aktiviteteve edukative të NETCET me nxënësit e shkollave

Në aktivitetet e NETCET për ndërgjegjësimin dhe shpërndarjen e informacionit mbi cetacetë dhe breshkat detare, është parashikuar edhe përfshirja e nxënësve të shkollave fillore dhe 9-vjeçare. Rritja e ndërgjegjës së fëmijëve të peshkatarëve, të përdoruesve të anijeve dhe të përdoruesve të detit në përgjithësi është e një rëndësie të veçantë për projektin.

Takimet me nxënësit filluan në Itali, në pranverën e këtij viti dhe u organizuan nga operatorët e qendrave të reabilitimit dhe emergjencës të Projektit NETCET. Në këto takime janë përdorur tre lloje posterash dhe mjete audio-vizive (video dhe prezantime në Power Point). Temat e trajtuara për fëmijët lidheshin kryesisht me karakteristikat biologjike dhe ekologjike të llojeve të breshkave detare dhe cetaceve të Adriatikut dhe sidomos me problemet që ato mund të përballen për shkak të ndikimit të njeriut. Interesi i fëmijëve për këto tema ishte shumë i lartë, por krahas entuziazmit dhe shtimit të njohurive për këto lloje, aktivitetet e projektit synojnë edhe në rritjen e përgjegjshmërisë dhe të kuptuarit e faktit se edhe veprime të thjeshta të jetës së përditshme duke respektuar mjedisin mund të ndihmojnë në ruajtjen e këtyre llojeve detare. Për shembull, materialet plastike të hedhura në det mund të shkaktojnë probleme serioze për breshkat dhe delfinët, nëse ato gëlltiten. Kështu, veprime të thjeshta por të kujdesshme për shmangien e hedhjes së mbeturinave plastike në det mund t'i shpëtojnë kafshët detare nga këto probleme.



Qendra e reabilitimit në Riçone, e menaxhuar nga Fondacioni Cetacea, ka organizuar deri tani 34 orë leksione me grupe të ndryshme, ku kanë marrë pjesë 471 nxënës dhe do të vazhdojë përsëri gjatë vitit të ardhshëm shkollor (2014/2015).

Në Veneto leksionet me nxënësit janë organizuar nga Muzeu i Historisë së Natyrës i Venecias, me ndihmën e Bashkisë së Venecias si koordinator i Projektit NETCET. Këto leksione u ndoqën nga rreth 100 nxënës dhe mësues, të cilët morën pjesë në aktivitetet dhe lojrat për breshkat detare. Mësuesve dhe nxënësve që morën pjesë, u është kërkuar që të shpërndajnë njohuritë e fituara tek nxënësit e tjerë të shkollave. Materialet



edukative (postera, vizatime, prezantime audio-vizive) mund t'u shfaqen nxënësve të tjerë të shkollës dhe mund të ri-përdoren në vitet e ardhëshme.

*Antonio Socci, Natural History Museum dhe Valeria Angelini, Fondazioni Cetacea*

## 6. Bashkia e Venecias promovon një praktikë të mirë për projektin NETCET

Një nga qëllimet e Bashkisë së Venecias është mbrojtja e cetaceve dhe breshkave detare të Adriatikut që kërcënohen nga aktivitetet e njeriut. Çdo vit, një numër i konsiderueshëm i këtyre kafshëve dalin të plagosura ose të ngordhura në brigjet e Venetos. Për arsye shkencore dhe ekologjike është e rëndësishme të njihen rrugët e tyre të lëvizjes dhe migrimit në Detin Adriatik, duke përdorur database ku të shënohet çdo rast i vëzhgimit të tyre.

Bashkia e Venecias ka vendosur të bëjë lidhjen e Projektit NETCET me një projekt tjetër të zonës së Venetos, i quajtur Atlasi i Lagunës, i nisur në vitin 2002 nga një ide e Departamentit të Observatorit të Lagunës dhe Territorit të Bashkisë së Venecias

(<http://www.silvenezia.it/>).

Atlasi i Lagunës është një portal web i cili lejon futjen në të dhënat gjeografike mjedisore mbi Lagunën e Venecias, të prodhuara nga një sërë institucionesh publike. Ky Atlas është një mjet pune dhe informacioni për ruajtjen dhe mbrojtjen e lagunës, pjesës

kontinentale dhe detit të zonës së Venetos. Megjithëse laguna është pjesa më me interes e Atlasit, aty gjenden të dhëna mjedisore edhe për pellgun e saj ujëmbledhës dhe ujrë bregdetare. Objektivi kryesor i Atlasit është që të organizojë dhe të koordinojë informacionet e prodhuara nga institucione të ndryshme, në



mënyrë që përdoruesit e këtyre informacioneve (ekspertë, institucione, organizata, qytetarë...) t'i referohen një database të unifikuar.

Atlasi është i përbërë nga një seri hartash interaktive, të ilustruara me tekst, tabela, foto dhe database të jashtme (anekse) mbi karakteristikat mjedisore. Këto harta janë krijuar në sajë të kontributit të disa partnerëve që punojnë me të dhëna mjedisore të përbashkëta. Këto të dhëna janë të hapura dhe falas për çdo të interesuar. Aktualisht janë 12 partnerë që bashkëpunojnë për zhvillimin e Atlasit. Secili partner kontrollon dhe përditëson të dhënat e tij përmes internetit dhe duke përdorur liçenca kompatibël me Open Definition, sipas të cilave një e dhënë është e hapur për përdorim nëse çdokush është në gjendje ta përdorë, ripërdorë dhe shpërndajë atë thjeshtë dhe falas. I vetmi detyrim është që të përmendet burimi i të dhënave. Të dhënat janë grumbulluar në 453 shtresa dhe në 11 tematika. Shtresat mund të mbivendosen me njëra-tjetrën, duke lejuar krahasimet ndërmjet grupeve të të dhënave.

Në sajë të bashkëpunimit të Muzeut të Historisë së Natyrës, Bashkia e Venecias është duke punuar për krijimin e një shtrese tjetër të të dhënave, dedikuar vëzhgimeve të breshkave detare. Çdo vëzhgim do të paraqitet me koordinata gjeografike dhe të dhëna për datën dhe kohën e vëzhgimit, llojin e breshkës, si dhe me informacione të tjera me interes, si p.sh nëse është e plagosur, e ngordhur etj. Atlasi përditësohet në mënyrë të vazhdueshme.

Bashkia e Venecias është duke përmirësuar të dhenat mbi detin, me qëllim krahasimin e vëzhgimeve të breshkave me shtresat e tjera, si ato që lidhen me ndotjen ose praninë e njeriut, në mënyrë që të krijojë një metodë dinamike të vlerësimit të zhvillimeve, kuptimit të shkaqëve dhe pasojave të dëmtimit apo ngordhjes së breshkave, ose edhe thjeshtë për të analizuar praninë e breshkave detare në një zonë të caktuar të Adriatikut. Kjo praktikë e mirë mund të përdoret edhe si mbështetje për qendrën e shpëtimit të breshkave në Veneto, e cila do të hapet së shpejti në ishullin Lido.

Carla Santoro, Bashkia e Venecias

## LAJME SHKURT



### Takimi i ardhshëm i partnerëve të projektit në Tiranë (Shqipëri): 1-2 Tetor 2014

Takimi i ardhshëm i partnerëve të projektit do të mbahet në Tiranë (Shqipëri), me 1-2 Tetor 2014 dhe do të organizohet nga HAS. Ky aktivitet do të jetë një mundësi e mirë për partnerët e projektit NETCET për të vlerësuar rezultatet e deritanishme dhe planet mbi aktivitetet e ardhshme dhe realizimin e objektivave të projektit.



The project is co-funded by the European Union,  
Instrument for Pre-Accession Assistance.



## Contact

City of Venice

+39 041 2747826 / 7830 / 7834

European Policies Division

[www.netcet.eu](http://www.netcet.eu)

San Marco 4299  
30124 Venice - Italy

[www.facebook.com/NETCETproject](https://www.facebook.com/NETCETproject)

[info@netcet.eu](mailto:info@netcet.eu)

This Newsletter has been produced with the financial assistance of the IPA Adriatic Cross-Border Cooperation Programme. The contents of this Newsletter are the sole responsibility of the City of Venice and can under no circumstances be regarded as reflecting the position of the IPA Adriatic Cross-Border Cooperation Programme Authorities.